

28.03.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

Nr. 348/Prot.  
2

Tiranë, më 28.03.2024

MIRATOHET



PROGRAM AUDITIMI  
PËRPUTHSHMËRIE

PËR PROJEKTIN "NDËRTIMI I QENDRËS RAJONALE TË MENAXHIMIT  
TË INTEGRUAR TË MBETJEVE NË SHERISHTË TË VLORËS"

Subjekti i auditimit:

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;  
Agjencia Ujësjetllës Kanalizimeve;  
Bashkia Vlorë.

Lloji i auditimit:

Auditim i përputhshmërisë.

Objektivat e Auditimit:

Dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e zbatimit nga subjektet e audituara të ligjeve, vendimeve, udhëzuesve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është përcaktuar veprimtaria e projektit.

Qëllimi i Auditimit:

Të vlerësojë dhe evidentojë shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, si dhe shfrytëzimin me eficiencë, efektivitet dhe ekonomikitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Ndërmarrjen e veprimeve korigjuese sipas rastit, rritjen e përgjegjshmërisë, llogaridhënies, rikuperimin e dëmeve të shkaktuara si dhe parandalimin e shkeljeve, me synim rritjen e vlerës së parasë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve. Gjithashtu qëllimi i auditimit është raportimi mbi gjetjet,

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", nr. 1, Tiranë. E-mail: [klsh.org.al](mailto:klsh.org.al); website: [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al)

	konkluzionet dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes.
<b>Metoda e auditimit:</b>	Auditim mbi bazë risku.
<b>Periudha e auditimit:</b>	Nga data e fillimit të projektit deri në datën 31.03.2024.
<b>Afati i auditimit:</b>	Nga data 29.03.2024 deri në datën 31.05.2024.
<b>Grupi i auditimit:</b>	Artan Topjana (Përgjegjës grupi), Brunilda Zeneli, Jupitern Malaj, Adhurim Banushaj, anëtarë.
<b>Dokumentimi i auditimit:</b>	Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara akt konstatimeve dhe akt verifikimeve, si dhe shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar do të përgatitet Projekt Raporti i Auditimit, i cili do të jetë materiali bazë për hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.
<b>Kontrolli i Cilësisë:</b>	Ndjekja, mbikëqyrja e punës audituese dhe kontrolli i cilësisë, do të kryhet në përputhje me “Rregulloren e procedurave të auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin Nr.7, datë 27.01.2024, si dhe udhëzuesin e Menaxhimit të Cilësisë së Auditimit të KLSH.

**I. Baza ligjore për kryerjen e auditimit:**

Lloji Dokumentit	Detajet e bazës ligjore dhe rregullatore që do të përdoret
<b>Standardet e Auditimit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t;</li> <li>- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);</li> <li>- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë.</li> <li>- Rregulloren e procedurave të auditimit në KLSH”, etj.</li> </ul>
<b>Ligje</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.</li> <li>- Ligji nr. 20/2017 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave (Huamarrësi) dhe KFË Frankfurt AM Main (KfË), për programin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta Rajoni Vlorë”.</li> <li>- Ligji nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar.</li> <li>- Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar.</li> <li>- Ligji nr. 8094/1996, “Për largimin publik të mbeturinave”, siguron bazën ligjore, nëpërmjet së cilës bashkitë mund të kontraktojnë shërbimin në palë të treta me kontrata menaxhimi që mund të zgjasin deri në 5 vjet.</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", me ndryshime.</li> <li>- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", me ndryshimet përkatëse, etj.</li> </ul>
<b>Vendime të Këshillit të Ministrave (VKM)</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- VKM nr. 116, datë 24.02.1997 "Për kompetencat, procedurat, nënshkrimin, lëvrimin, regjistrimin, zbatimin, shlyerjen dhe raportimin e huave, kredive dhe ndihmave të huaja që i jepen Qeverisë së Republikës së Shqipërisë".</li> <li>- VKM nr. 452, datë 01.07.1998 "Për disa masa në përmirësimin e punës për financimin e projekteve që financohen nga donatorë të huaj".</li> <li>- VKM nr. 178, datë 6.3.2012, "Për incinerimin e mbetjeve".</li> <li>- VKM nr. 452, datë 11.7.2012, "Për lëndfillet e mbetjeve";</li> <li>- VKM nr. 967, datë 25.10.2013, "Për ngritjen e grupit të punës për Komitetin e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve".</li> <li>- VKM nr. 418, datë 25.6.2014, "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim".</li> <li>- VKM nr. 687, datë 29.7.2015, "Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve".</li> <li>- VKM nr. 319, datë 31.5.2018, "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve".</li> <li>- VKM nr. 389, datë 27.6.2018, "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 452, datë 11.7.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për lëndfillet e mbetjeve".</li> </ul>
<b>Rregullore, Udhëzues, Akte të tjera Administrative</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëzim i Ministrisë së Financave nr. 8, datë 17.02.2003 "Për evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja, në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huaj".</li> <li>- Udhëzuesit e Huadhënësit, për prokurimin e fondeve për punime, mallra dhe shërbimeve.</li> <li>- Udhëzim i Ministrisë së Financave nr. 20, datë 24.12.2003 "Për përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore të njësisive të menaxhimit/zbatimit të projekteve dhe marrëveshjeve me donatorë të huaj".</li> </ul>
<b>Të tjera</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Akte të tjera ligjore apo nënligjore që do të jenë të nevojshme gjatë auditimit.</li> </ul>

## II. Drejtimit kryesore te auditimit:

Drejtimit kryesore sipas të cilave do të zhvillohet veprimtaria audituese paraqiten si më poshtë:

### 1. Marrëveshjet e financimit të projektit me huadhënësit, ndryshimet, shkaqet dhe argumentimi i ndryshimeve.

1.1. Mbi ndjekjen e procedurave ligjore në miratimin e marrëveshjes së financimit.

1.2. Mbi ndjekjen e procedurave ligjore në ngritjen e strukturave për funksionimin e marrëveshjes së financimit.

1.3. Mbi ndjekjen e procedurave ligjore në ndryshimet e marrëveshjes së financimit, arsyet e ndryshimeve, si dhe miratimin e ndryshimeve.

[Shqiptaria.com]